

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"SPADE STUDIOS" Sh.p.k**

Ne Tirane, sot me datë 10/06/2024, une **SAID ARAMAN** , person me shtetesi Siriane , i datelindjes 01/01/2003, Mbajtes i kartes me nr K33101002U, me zotësi të plotë juridike per të vepruar, nenshkruaj kete Akt Themelimi te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "SPADE STUDIOS" Sh.p.k

Neni 1

Forma e shoqerise

Ortaku themelon një shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne kuptimin qe pergjegjesia e tij eshte e kufizuar deri ne shumen e kapitalit te derdhur, pa iu njohur asnje pergjegjesi tjetere.

Neni 2

Emertimi i shoqerise

Emertimi i shoqerise eshte "SPADE STUDIOS" Sh.p.k

Neni 3

Baza juridike

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat e Statutit e Aktit te Themelimit.


Neni 4

Objekti i veprimtarise

4.1 Veprimtaria e Shoqerisë "SPADE STUDIOS" Sh.p.k do të ketë për objekt :

Marketing, Design, Fotografimi

4.2 Shoqëria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, mund të kryejë cdo operacion prodhimi, tregtar dhe

Said Araman


financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit.

4.3 Shoqëria, me vendim të Administratorit mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

4.4 Për të realizuar qellimet e saj Shoqëria mund të sigurojë dhe perdore financime nga ortakët, nga vende të tjera ose nga institucione financiare vendase ose të huaja.

4.5 Objekti i shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet ose të pakesohet në baze të vendimit të administratorit.

Neni 5 Selia

4.1. Shoqëria "SPADE STUDIOS" Sh.p.k e ka seline e saj në adresën:

Rruga TeftaTashko, Ndert Nr 3, Njesia administrative nr 2, zona kadastrale 8350, Tirane.

Neni 6 Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë për një periudhë të pacaktuar kohore.

Neni 7 Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë "SPADE STUDIOS" Sh.p.k është 500.000 (Pese qind mijë) Leke.

Kapitali do të perbehet në 1(një) kuot,

Neni 8 Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga 1 Administrator.

Administrator i shoqërisë do të jetë z. SAID ARAMAN , Mbajtes i kartes me nr K33101002U

Said Araman


Neni 9
Viti financiar

Vitet financiare perputhen me vitin kalendarik. Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik. Perjashtimisht, viti i pare financiar do te filloje nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe do te mbyllet ne fund te vitit perkates.

Neni 10
Te ardhurat neto

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise ne raport me kuotat e tyre ne kapitalin fillestar. Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo ushtrimori, ne perputhje me parashikimet e statutit dhe pas pagimit te tatimeve, dhe rezerves se domosdoshme, te konkretizuara ne bilance, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise.

Neni 11
Juridiksioni

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundertet, kompetente per zgjidhjen e tyre jane Gjykatat Shqiptare.

Ky Akt themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar , eshte hartuar ne 5 kopje ne gjuhen Shqipe dhe pasi lexohet, nenshkruhet rregullisht nga ortak themelues.

ORTAKU I VETEM

SPADE STUDIOS

SAID ARAMAN

